



# REKOMANDIME MBI GRUP MOSHAT DHE FORMAT E DEPISTIMIT



## Gratë e moshës 20-30 vjeç

**Nuk rekomandohet mamografi**

**Rekomandohet ekzaminimi klinik i gjirit** nga mjekë apo mami të trajnuar në shërbimin parësor.

Shpeshtësia e rekomanduar çdo tre vjet.

**Nuk rekomandohet, por për gratë që janë të interesuara, këshillohet vetëekzaminimi i gjirit çdo muaj bazuar në instruktimin e dhënë nga mjeku.**

Gratë duhet të informohen për nivelin shumë të ulët për kancer gjiri në këtë moshë, por nëpërmjet aplikimit të ekzaminimit klinik dhe vetëekzaminimit ato jo vetëm ndihmojnë kapjen e herëshme të kancerit por edhe përgatiten për të bashkëpunuar më tepër në të ardhmen me programet e depistimit.

## Gratë e moshës 40-50 vjeç

Depistimi me **mamografi para moshës 50 vjeç nuk është i këshillueshëm**

për arsye të kostoeftektivitetit të ulët që ofron. Sensitiviteti i mamografisë nën këtë moshë nuk është optimal. Në vendet ku kjo është rekomanduar është vërejtur se shpejtësia e zhvillimit të kancerit ka qenë më e madhe se sa shpeshtësia e kryerjes së mamografive.

Grave të interesuara mund tu rekomandohet ta kryejnë mamografinë çdo vit.

**Rekomandohet ekzaminim klinik i gjirit** si më sipër.

**Këshillohet vetëekzaminimi i gjirit** si më sipër nga mjekët e shërbimit parësor për gratë e interesuara

## Gratë nga moshë 50 deri 70 vjeç

**Rekomandohet kryerja e mamografise depistuese çdo dy vjet.**

Disa studime dëshmojnë se ekziston potenciali që nesë arrihet një mbulim i kenaqshëm i popullsisë me depistim mund të parandalohen deri në 30% të vdekjeve nga kanceri i gjirit për këtë grup moshe.

**Ekzaminimi klinik i gjirit dhe vetëekzaminimi i gjirit rekomandohen të përdoren si teknika ekzaminuese komplementare të mamografisë.**

Ato mund ti përgatisin gratë më mirë për të marrë pjesë në depistimin me mamografinë

Për më shumë detaje lidhur me modalitetet e vlerësimit për grupet me risk më të lartë se mesatarja (shih tabelen e vlerësimit të riskut)

Detajet e menaxhimit të rezultateve të ekzaminimit klinik të gjirit i gjeni në algoritmet përkatëse nga 1 deri ne 5



INSTITUTI I SHËNDËTIT PUBLIK



MALTESER



IAEA